# DEKLARATË E PËRBASHKËT E ORGANIZATAVE MJEDISORE

# FORUMI KOMBËTAR "RUAJMË NATYRËN PËR NJË BASHKËJETESË TË QËNDRUESHME"

NE, përfaqësuesit e Organizatave të Shoqërisë Civile dhe institucioneve akademike-kërkimore që kontribuojnë në fushën e studimeve për ruajtjen e natyrës dhe zhvillimit të qëndrueshëm, të mbledhur më 26 Maj 2023, në Tiranë, në "Forumin [1] Kombëtar Ruajmë Natyrën për një Bashkëjetesë të Qëndrueshme", diskutuam mbi çështjet e ruajtjes së natyrës brenda dhe jashtë zonave të mbrojtura dhe rolin që organizatat/aktorët e ndryshëm duhet të luajnë për të garantuar një përdorim të qëndrueshëm të burimeve natyrore që kontribuon në ruajtjen e vlerave të natyrës dhe biodiversitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e social.

Shqipëria konsiderohet një pikë e nxehtë e biodiversitetit në Evropë. Megjithatë, OSHC-të vërejnë se një biodiversitet i tillë i jashtëzakonshëm dhe burime të vlefshme natyrore po përballen me sfida. Si vendet e tjera në zhvillim, edhe Shqipëria po përballet me një zhvillim të shpejtë. Rrugët dhe infrastrukturat e reja, digat, hidrocentralet, rezervuarët e naftës dhe infrastruktura e turizmit masiv synojnë të rrisin ekonominë e vendit, ndërkohë që përbëjnë një kërcënim serioz për mbrojtjen e natyrës.

Sipas Raportit të 6-të Kombëtar të Konventës për Diversitetin Biologjik (CBD) (2019), faktorët kryesorë të humbjes së diversitetit biologjik janë aktivitetet antropogjenë. Kërcënimet kryesore për biodiversitetin përfshijnë: zhvillimin industrial, urbanizimin, gjuetinë e paligjshme, peshkimin, erozionin e tokës, energjinë dhe minierat, transportin dhe turizmin.

Bashkëpunimi sektorial dhe integrimi i biodiversitetit në politikat sektoriale për energjinë, bujqësinë, menaxhimin e ujërave, pylltarinë, planifikimin hapësinor dhe urban dhe sektorët e ndërtimit është minimal. Pavarësisht përpjekjeve të shumta, ka pasur pak integrim të elementeve të ruajtjes së natyrës në politikat strategjike dhe planifikimin sektorial.

Duke njohur rolin e rëndësishëm që kanë zonat e mbrojtura në ruajtjen e biodiversitetit, Shqipëria ka bërë përpjekje për krijimin dhe zgjerimin e rrjetit të zonave të mbrojtura. Në veçanti, vendi ka bërë përparim të rëndësishëm në përmirësimin e mbulimit të sistemit të tij të zonave të mbrojtura gjatë 20 viteve të fundit, duke zgjeruar në mënyrë të ndjeshme shtrirjen e zonave të mbrojtura nga 163,901 ha (5.7%) në 2000, në 460,762 ha (16%)në 2015 dhe në 624.172 ha (21.7%) në 2023. Në shkurt të vitit 2022, Shqipëria u bashkua në Koalicionin e Ambicies së Lartë për Natyrën dhe Njerëzit, duke u zotuar të mbrojë të paktën 30% të territorit të saj tokësor dhe detar dhe të promovojë zgjidhje të bazuara në natyrë brenda Konventës Kuadër të OKB-së për Ndryshimet Klimatike.

Direktivat për Shpendët e Egër dhe Habitatet janë pjesa qendrore e përpjekjeve evropiane për ruajtjen e natyrës. Këto direktiva shumë të rëndësishme rregullojnë mbrojtjen e specieve dhe habitateve nëpërmjet krijimit dhe menaxhimit të duhur të një rrjeti zonash të mbrojtura të njohur si

[1] Forumi, organizuar nga INCA në kuadër të programit GreenAL, financuar nga Ambasada Suedeze dhe zbatuar nga Co-PLAN në bashkëpunim me CISP, VIS dhe COSV, bëri bashkë një sërë aktorësh të angazhuar në ruajtjen e vlerave natyrore dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Shqipëri, duke përfshirë organizata jofitimprurëse, grupe përdoruesish të burimeve natyrore, përfaqësues të institucioneve qendrore dhe vendore përgjegjëse për menaxhimin e burimeve natyrore, donatorë aktivë në mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm etj.

rrjeti Natyra 2000. Në Raportin e tij të Progresit 2022 për Shqipërinë, Komisioni Evropian (KE) vëren se përafrimi i legjislacionit kombëtar me acquis në fushën e mbrojtjes së natyrës, veçanërisht për Direktivat e Shpendëve dhe Habitateve, është mjaft i avancuar. Megjithatë, zbatimi është në një fazë shumë fillestare dhe përballet me një sërë sfidash, duke përfshirë kapacitetet e dobëta institucionale, bashkëpunimin e kufizuar ndërmjet strukturave përgjegjëse qeveritare, përfshirjen e kufizuar të institucioneve akademike dhe kërkimore dhe mungesën e burimeve adekuate financiare. Raporti vuri në dukje gjithashtu se zbatimi i ligjit në mbrojtjen e mjedisit mbetet përgjithësisht i dobët. Për më tepër, legjislacioni për investimet strategjike ngre shqetësime për mbrojtjen e biodiversitetit, pasi mund të çojë në investime të mëdha turistike dhe industriale në zonat e mbrojtura. Vëmendja e duhur duhet t'i kushtohet hartimit të projekteve dhe cilësisë e standardeve për Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis (VNM) për të minimizuar ndikimet e mundshme.

Korniza Globale e Biodiversitetit pas vitit 2020 kërkon mbrojtjen e të paktën 30% të tokës tokësore dhe detare deri në vitin 2030, por thekson se është po aq e rëndësishme që këto përpjekje të plotësohen dhe të mbështeten nga një menaxhim më i qëndrueshëm i 70% të mbetur të peizazheve tokësore dhe peizazheve detare në një qasje globale. Zonat e mbrojtura janë mekanizmi kryesor për ruajtjen e biodiversitetit. Megjithatë, është e një rëndësie të madhe promovimi i një zhvillimi të qëndrueshëm mjedisor dhe përdorimi i mençur i burimeve natyrore edhe në zonat ngjitur me zonat e mbrojtura për të mbrojtur më tej këto vlera.

Në përmbledhje të diskutimeve dhe referimeve gjatë forumit, aktivistët e shoqërisë civile mjedisore dhe ekspertët e ruajtjes së natyrës dhe zhvillimit të qëndrueshëm konstatojnë se:

- Ekonomia, jetesa dhe mirëqenia jonë varen nga pasuria jonë më e çmuar: Natyra. Ne (njerëzimi) jemi pjesë e Natyrës, jo të ndarë prej saj. Ne kemi dështuar kolektivisht të angazhohemi me Natyrën në mënyrë të qëndrueshme, në masën që kërkesat tona e tejkalojnë kapacitetin e saj për të na furnizuar me mallrat dhe shërbimet ku të gjithë mbështetemi. Angazhimi ynë i paqëndrueshëm me Natyrën po rrezikon[2] prosperitetin e brezave të tanishëm dhe të ardhshëm.
- Biodiversiteti i mundëson Natyrës të jetë produktive, elastike dhe e adaptueshme. Humbja e vazhdueshme e biodiversitetit dhe efektet e ndryshimeve klimatike pritet të përkeqësojnë presionin tashmë të rëndë mbi ekosistemet dhe të ndikojnë në kontributin e tij në mirëqenien e njerëzve.
- Vlera e natyrës për shoqërinë – vlera e vërtetë e të mirave dhe shërbimeve të ndryshme që ofron – nuk reflektohet në çmimet e tregut, sepse pjesa më e madhe e saj është e hapur për të gjithë pa pagesë monetare. Për më tepër, aspektet e Natyrës janë të lëvizshme; disa janë të padukshme, e shpesh punojnë në heshtje.
- Rritja dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik arrihet vetëm kur llogarisim plotësisht ndikimin e ndër-veprimeve tona me Natyrën dhe ribalancojmë kërkesën tonë me kapacitetin e Natyrës.
- Ruajtja dhe restaurimi i pasurive tona natyrore do të mbështesë dhe përmirësojë furnizimin e tyre. Është më pak e kushtueshme për të ruajtur Natyrën sesa për ta rivendosur atë pasi të jetë dëmtuar ose degraduar, duke qenë të gjitha të tjerat të barabarta.

[2] Vlerësimet e ndikimit tonë total në Natyrë sugjerojnë se do të na duhen 1.6 Toka për të ruajtur standardet aktuale të jetesës në botë. (The Economics of Biodiversity – The Dasgupta Review, 2021)

- Rritja dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik kërkon që ne të marrim një rrugë tjetër, ku angazhimet tona me Natyrën jo vetëm të jenë të qëndrueshme, por edhe të rrisin pasurinë dhe mirëqenien tonë kolektive dhe të pasardhësve tanë.
- Zgjedhja e një rruge të qëndrueshme do të kërkojë ndryshime transformuese, të mbështetura nga nivele të larta ambicieje, koordinimi dhe vullneti politik.

***Modelet e konsumit dhe prodhimit do të duhet të ristrukturohen rrënjësisht.*** Thyerja e lidhjeve midis formave të dëmshme të konsumit dhe prodhimit dhe Natyrës mund të përshpejtohet përmes një sërë politikash që ndryshojnë normat e sjelljes dhe përafrojnë objektivat mjedisore përgjatë të gjithë zinxhirëve të furnizimit (p.sh., politika të reduktimit të mbetjeve, ripërdorimit, riciklimit, në vend të incenerimit; politika të përdorimit të burimeve alternative të energjisë, në vend të politikave aktuale të gazifikimit të Shqipërisë).

Zgjerimi dhe përmirësimi i menaxhimit të Zonave të Mbrojtura luan një rol thelbësor në këtë drejtim. Peizazhet natyrore shumë funksionale, që ofrojnë të mira dhe shërbime të ekosistemit, si dhe mbrojnë dhe përmirësojnë biodiversitetin, janë gjithashtu të rëndësishme. Zgjidhjet e bazuara në natyrë mund të ofrojnë mjete natyrore mbrojtjeje kundër rreziqeve të shtuara natyrore dhe rrisin qëndrueshmërinë duke mbrojtur ekosistemet dhe biodiversitetin. Marrëveshja e Gjelbër Evropiane dhe Korniza Globale e Biodiversitetit CBD pas 2020 hapin mundësi të reja për të zgjeruar zgjidhjet e bazuara në natyrë që mbështesin zhvillimin socio-ekonomik dhe ruajtjen e biodiversitetit. ***Investimi në shkallë të gjerë dhe i përhapur në zgjidhjet e bazuara në natyrë do të ndihmojë për të trajtuar humbjen e biodiversitetit dhe do të kontribuojë ndjeshëm në zbutjen dhe përshtatjen e ndryshimeve klimatike, për të mos përmendur përfitimet më të gjera ekonomike, duke përfshirë krijimin e vendeve të punës***.

***Natyra duhet të hyjë në vendimmarrjet ekonomike dhe financiare***. Futja e kapitalit natyror në sistemet kombëtare të kontabilitetit është një hap kritik për ta bërë "pasurinë gjithëpërfshirëse"[3] treguesin tonë të progresit.

Mundësimi i ndryshimeve ***kërkon veprime kolektive dhe të qëndrueshme për të transformuar sistemet që mbështesin angazhimet tona me Natyrën***, mbi të gjitha sistemet tona financiare dhe arsimore. Flukset financiare të dedikuara për ruajtjen dhe zgjerimin e aseteve tona natyrore janë të vogla krahasuar me subvencionet dhe flukset e tjera financiare që dëmtojnë këto asete. Sistemi financiar duhet të kanalizojë investimet– publike dhe private – drejt aktiviteteve ekonomike që rrisin stokun tonë të aseteve natyrore dhe inkurajojnë konsumin dhe aktivitetet e prodhimit të qëndrueshëm.

Aktorët financiarë duhet të ndihmojnë gjithashtu në menaxhimin dhe zbutjen e rreziqeve dhe pasigurisë që vjen nga angazhimi ynë i paqëndrueshëm me Natyrën. Bizneset dhe institucionet financiare mund ta bëjnë këtë duke llogaritur varësitë dhe ndikimet në natyrë të aktiviteteve të

[3] Si treguesi kryesor i suksesit ekonomik, Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) nuk merr parasysh zhvlerësimin e aseteve, duke përfshirë mjedisin natyror, duke na inkurajuar të ndjekim rritje dhe zhvillim të paqëndrueshëm ekonomik. Për të gjykuar nëse zhvillimi ekonomik është i qëndrueshëm, nevojitet një tregues gjithëpërfshirës i pasurisë. "Pasuria gjithëpërfshirëse" siguron një tregues të qartë dhe koherent që korrespondon drejtpërdrejt me mirëqenien e brezave të tanishëm dhe të ardhshëm, duke matur pasurinë tonë në terma të të gjitha aseteve, përfshirë asetet natyrore. (The Economics of Biodiversity – The Dasgupta Review, 2021)

tyre; dhe nëpërmjet matjes dhe divulgimit, jo vetëm të rreziqeve financiare të lidhura me klimën, por edhe të rreziqeve financiare që lidhen me natyrën.

Megjithatë, mbështetja vetëm tek institucionet për të mundësuar ndryshimin nuk mjafton. Ndërhyrjet që i ndihmojnë njerëzit të kuptojnë dhe të lidhen me Natyrën jo vetëm që do të përmirësonin shëndetin dhe mirëqenien e tyre, por gjithashtu do të ndihmonin në fuqizimin e qytetarëve për të bërë zgjedhje të informuara dhe për të kërkuar ndryshimin që nevojitet. Prandaj, përfshirja e botës natyrore në politikën arsimore është thelbësore. ***Zhvillimi dhe hartimi i programeve të edukimit mjedisor mund të ndihmojë në arritjen e një ndikimi të prekshëm, duke u fokusuar në çështjet lokale dhe duke bashkëpunuar me shkencëtarët dhe organizatat e shoqërisë civile.***

***Ndryshimi transformues i nevojshëm në zgjedhjen e rrugës së qëndrueshme kërkon reflektim dhe angazhim të vazhdueshëm të aktorëve në të gjitha nivelet.*** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si institucioni lider në fushën e mbrojtjes së natyrës, si dhe institucionet e tjera të qeverisjes qendrore dhe vendore, akademia, sektori privat dhe donatorët ***duhet të bashkërendojnë më mirë strategjitë, programet dhe aktivitetet e tyre për të garantuar jo vetëm një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, por edhe ruajtjen dhe përmirësimin e statusit të burimeve natyrore dhe të biodiversitetit në vend***.

Për të siguruar një ruajtje afatgjatë të burimeve natyrore dhe biodiversitetit dhe përdorimin e tyre të qëndrueshëm, është me rëndësi thelbësore që vendimet dhe veprimet në lidhje me ruajtjen e natyrës të mbështeten me prova të shëndosha shkencore. Shqipëria ka nevojë për ndërtimin dhe përmirësimin e njohurive për përdorimin e teknologjive të reja për avancimin e ruajtjes së kapitalit të saj natyror. Informacioni për biodiversitetin, i mbledhur, menaxhuar dhe shkëmbyer në mënyrë adekuate, është i nevojshëm për vendimmarrjen e bazuar në fakte dhe monitorimin e ndikimeve mjedisore. ***Potenciali qëndron në rritjen e përfshirjes së shoqërisë civile dhe qytetarëve, së bashku me integrimin e kontributit të tyre në bazat e të dhënave ekzistuese të informacionit. Shkenca qytetare dhe kompetencat dixhitale po bëhen një mjet gjithnjë e më i rëndësishëm për një qasje më gjithëpërfshirëse ndaj ruajtjes së natyrës.*** Ndërsa Shqipëria përgatitet të marrë investime dhe të zhvillojë një ekonomi moderne, informacioni mbi biodiversitetin do të bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm për të siguruar që aktivitetet ekonomike të kryhen brenda kufijve mjedisorë.

Organizatat e Shoqërisë Civile kanë kapacitete dhe potencial të shumanshëm për të kontribuar në procesin e zhvillimit të qëndrueshëm, si në ndërgjegjësimin, informimin dhe edukimin e publikut, ashtu edhe në ofrimin dhe përmirësimin e njohurive dhe promovimin e teknologjive të reja. Përfshirja e detyrueshme dhe serioze e Organizatave të Shoqërisë Civile në proceset e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të programeve dhe strategjive për zhvillim të qëndrueshëm është parësore për të siguruar ndryshimin transformues të kërkuar.

**Për të adresuar këto problematika, NE, përfaqësuesit e organizatave mjedisore, kërkojmë:**

1. Zbatimin rigoroz të parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, social e mjedisor në të gjithë territorin e vendit dhe jo vetëm brenda disa zonave të mbrojtura. Për këtë duhet:

- Bashkërendim i strategjive, programeve dhe aktiviteteve të institucioneve qendrore e vendore, institucioneve akademike, shoqërisë civile, sektorit privat dhe donatorëve;

- Hartimin dhe mbështetjen e politikave ndër sektoriale që mbështesin ekonominë qarkulluese (reduktim, ripërdorim, riciklim; burime alternative të energjisë);
- Përfshirjen serioze të të gjithë aktorëve të rëndësishëm në proceset e zhvillimit të qëndrueshëm dhe arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) .

2. Ristrukturimin dhe fuqizimin e mekanizmave që garantojnë zhvillimin e qëndrueshëm. Për këtë duhet të:

- Rishikohen procedurat dhe forcohen standardet për hartimin e raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) apo edhe të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM);
- Mbështeten proceset e vlerësimit të kapitali natyror dhe përfshirjes së tij në vendimmarrjet financiare për mbështetjen e projekteve të zhvillimit.

3. Përmirësimin e efektivitetit të menaxhimit të Zonave të Mbrojtura duke vlerësuar rigorozisht kontributin e tyre në arritjen e objektivave të ruajtjes së vlerave të spikatura natyrore, nëpërmjet një menaxhimi aktiv e të qëndrueshëm, mbështetur me kapacitetet e duhura njerëzore e financiare. Për këtë duhet:

- Përcaktimi i objektivave të ruajtjes së natyrës dhe indikatorëve të suksesit për secilën zonë të mbrojtur;
- Vlerësimi i efektivitetit të menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe shfrytëzimi i rezultateve për përmirësimin e menaxhimit;
- Plotësimi i burimeve njerëzore dhe alokimi i burimeve financiare të nevojshme.

4. Përmirësimin e njohurive mbi biodiversitetin dhe vlerat natyrore, duke përfshirë cilësinë dhe funksionin e habitateve dhe ekosistemeve dhe vlerësimin e kapitalit natyror. Për këtë duhet të:

- Hartohen manuale kombëtare për interpretimin e habitateve;
- Mbështeten institucionet dhe qendrat kërkimore shkencore në realizimin e vrojtimeve në terren për identifikimin dhe analizimin e habitateve dhe llojeve me rëndësi për ruajtjen e natyrës;
- Organizohen diskutime të grupeve të ekspertëve për të përmirësuar interpretimin dhe përshkrimin e llojeve dhe habitateve specifike;
- Identifikohen, plotësohen dhe mirëmbahen baza të dhënash për habitate dhe llojet në nivel kombëtar.

5. Rritjen e nivelit të informimit dhe ndërgjegjësimit të të gjithë aktorëve dhe publikut të gjerë mbi rëndësinë e ruajtjes së natyrës dhe zhvillimit të qëndrueshëm si dhe promovimin e praktikave të mira dhe mekanizmave që mbështesin aktivitetet social ekonomike me bazë natyrën. Për këtë duhet të:

- Ngrihet niveli dhe cilësia e programeve të edukimit mjedisor në shkolla përmes krijimit dhe/ose promovimit të aktiviteteve në natyrë në kurrikula arsimore;
- Përgatitet dhe realizohet një fushate informuese dhe ndërgjegjësuese për rëndësinë e zonave të mbrojtura e burimeve natyrore (përfshirë zonat Natyra 2000) në garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të komuniteteve vendore;

- Rritet ndërgjegjësimi midis aktorëve kryesorë për përfitimet nga aktivitetet e ruajtjes së natyrës dhe zhvillimit të qëndrueshëm (me efekte pozitive ekologjike dhe ekonomike) përmes promovimit të praktikave më të mira.

**Tiranë, 26 Maj 2023**

Forumi Kombëtar Ruajmë Natyrën për një Bashkëjetesë të Qëndrueshme

## Aneks 1 – Pjesëmarrja

# LISTË PJESËMARRJE

## FORUM KOMBËTAR "RUAJMË NATYRËN PËR NJË BASHKËJETESË TË QËNDRUESHME"

Hotel Xheko-Imperial, Tiranë 26.05.2023

| Nr. | Emër/Mbiemër | Subjekti | Titulli/Pozicioni | Numri i Telefonit | Adresa e E-mail | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Jonida Markja | CSDC Durrës | Koordinatore | 0697331735 | jonidamarkja1@gmail.com | [signature] |
| 2 | Bezjon Balliu | SHOQATA AKS | Student | 0686138262 | bezjon.balliu@gmail.com | BR |
| 3 | Kristina Dreka | Bashkia Elbasan | Përgj. NJIE | 0695833643 | kristinatavanxhiu@yahoo.c | [signature] |
| 4 | Sokol Meloshi | AGROPUKA | Dr. Ekzekutiv | 0682388169 | sokolmeloshi@yahoo | [signature] |
| 5 | Giovalin Alia | Shoqata ET Puke | Kryetar | 0682374024 | | [signature] |
| 6 | Anna Carboni | VIS Albania | Country Rep. | 0695718816 | anna.carboni@gmail.com | [signature] |
| 7 | Lavdosh Ferruni | SH.B.O | Drejtor | 0674667312 | lavdoshferruni@gmail.com | [signature] |
| 8 | Kejt Dhrami | Co-PLAN | Menaxh. Njësie | 0686232233 | kejt_dhrami@co-plan.org | [signature] |
| 9 | Violeta Zuna | UNDP | Menaxher | | violeta.zuna@undp.org | [signature] |
| 10 | Blerina Tyli | Bashkia Tiranë | Specialist | 0693451531 | blerinahoxha84@gmail.com | [signature] |
| 11 | Dorela Likaj | Bashkia Tiranë | Specialist | 0682548282 | tafadorela1@gmail.com | [signature] |
| 12 | Besnik Alku | ALCDF | Menaxher | 0682089376 | balku@alcdf.org | [signature] |
| 13 | Alton Mizo | org: "Mjedisi [illegible]" | Aktivist | 0686116812 | amizo.[illegible]@[illegible] | [signature] |
| 14 | Kejda Prendi | Milieu Kontakt | Internship | 0683258099 | kejda.prendi1@gmail.com | [signature] |
| 15 | Anton Gjuri | Federata Pyjore | – | 0688549977 | – | [signature] |

*Shënim: Duke firmosur këtë listë-prezencë, ju jeni dakord që fotografitë dhe regjistrimi i këtij Forumi të përdoren për publikim dhe raportim në kuadër të Green-AL*

# LISTË PJESËMARRJE

## FORUM KOMBËTAR "RUAJMË NATYRËN PËR NJË BASHKËJETESË TË QËNDRUESHME"

**Hotel Xheko-Imperial, Tiranë 26.05.2023**

| Nr. | Emër/Mbiemër | Subjekti | Titulli/Pozicioni | Numri i Telefonit | Adresa e E-mail | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Emilda Rrapaj | Menu Group | Koordinatore | 0693772922 | emildarrapaj@info.al | |
| 2 | CHIARA RANONDETTI | P.O. ASSISTENZA | CELIM | | ramondetti@celim.it | |
| 3 | GRETA BRAIDOTTI | CELIM | | 3406304451 | braidotti@celim.com | |
| 4 | Esmeralda Laci | RUR AL | Dr. ekzekutiv | 0693576076 | es_laci@yahoo.com | |
| 5 | ERMAL OHUZI | EKOLOGJET RUKES | KOORDINATOR | 0697886579 | ermalohuzi13 gmail.com | |
| 6 | Isuf Dervishi | Agri-En | Kryetar | 0695368166 | agrien.ty@gmail.com | |
| 7 | BESMIR GEZIQI | Co-PLAN | RFC | 0682910193 | besmir_geziqi@co-plan.org | |
| 8 | Mihallaq Qirjo | REC Albania | Drejtor | 0682038727 | director@recalbania.org | |
| 9 | Bexjan Ballin | SHOQATA LIBRAZHD AKS | STUDENT | 0686138262 | bexjan.ballin@gmail.com | BB |
| 10 | Blerina Tyli | Bashkia Tiranë | Specialist | 0693451531 | blerinahoxha84@gmail.com | |
| 11 | Dorela Likaj | Bashkia Tiranë | Specialist | 0692549282 | tafadorela1@gmail.com | |
| 12 | Besjana Guri | EcoAlbania | PR | 0692954214 | b.guri@ecoalbania.org | |
| 13 | Albana Zoholi | CCIT | Sekret. përg. | 0692410000 | albana_zoholi@cci.al | |
| 14 | JONIDA SHAHO | GAIA | FOUNDER | 0675424804 | info@gaiaalbania.al | |
| 15 | Klesta Golemi | Co-PLAN | Photographer | 0675057470 | klesta_golemi@co-plan.org | |

*Shënim: Duke firmosur këtë listë-prezencë, ju jeni dakord që fotografitë dhe regjistrimi i këtij Forumi të përdoren për publikim dhe raportim në kuadër të Green-AL*

# LISTË PJESËMARRJE

## FORUM KOMBËTAR "RUAJMË NATYRËN PËR NJË BASHKËJETESË TË QËNDRUESHME"

**Hotel Xheko-Imperial, Tiranë 26.05.2023**

| Nr. | Emër/Mbiemër | Subjekti | Titulli/Pozicioni | Numri i Telefonit | Adresa e E-mail | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Rea Muka | Co-PLAN | Planifikim | — | rea_muka@co-plan.org | [illegible] |
| 2 | Albana Jothe | MiA | Menaxhere projekti | 0672060447 | albana.jothe@[illegible] | [illegible] |
| 3 | Anni Kuraku | REC | PDO | 0691490680 | development@recshqiperia.org | [illegible] |
| 4 | Sonila Koci | VIS Albania | RFP | 0634641537 | vis.albania@volint.it | [illegible] |
| 5 | GIOVANNI TIMILLERO | AICS Tirana | Program Officer | 0693042487 | Giovanni.timillero@gmail.com | [illegible] |
| 6 | Rezarta Katuci | Amb. Suedeze | Prog. Oficer | 0694080893 | rezarta.katuci@gov.se | [illegible] |
| 7 | Isjola Sinjari | COSV | Drejtor | 0688813820 | isjola.sinjari@cosv.org | [illegible] |
| 8 | JONIDA SHAMO | COSV | Project officer | 0674424804 | jonida.shamo@cosv.org | [illegible] |
| 9 | Enerjeta Adhami | INCA | Project Coord. | 0682062157 | eni.adhami@gmail.com | [illegible] |
| 10 | Ali Delilaj | Mjedis, Ujëra, Pyje | Kryetar i Shoqatës | 0682035222 | alidelilaj13@gmail.com | [illegible] |
| 11 | Inuf Daminrli | MBZHR. | Specialist | 0686014889 | inuf.daminrli@bujqesia.gov.al | [illegible] |
| 12 | Laureta Bozo | Kuvendi | Prof. Dr. Ing. | 0682136140 | lulibozo@gmail.com | [illegible] |
| 13 | Melike Zyberaj | Hatixhe | Hatixhe | 0682804582 | [illegible].zyberaj@hotmail.com | [illegible] |
| 14 | Sara Korreshi | Co-Plan | RFP | 0698333529 | sara_korreshi@co-plan.org | [illegible] |
| 15 | | | | | | |

*Shënim: Duke firmosur këtë listë-prezencë, ju jeni dakord që fotografitë dhe regjistrimi i këtij Forumi të përdoren për publikim dhe raportim në kuadër të Green-AL*

Green-AL

INCA INSTITUTE FOR NATURE CONSERVATION IN ALBANIA

Green-AL

# LISTË PJESËMARRJE

## FORUM KOMBËTAR "RUAJMË NATYRËN PËR NJË BASHKËJETESË TË QËNDRUESHME"

**Hotel Xheko-Imperial, Tiranë 26.05.2023**

| Nr. | Emër/Mbiemër | Subjekti | Titulli/Pozicioni | Numri i Telefonit | Adresa e E-mail | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Enxhiana Torra | Shoqata e perdoruesve të burimeve natyrore Velçan | Antare | 0696675968 | torraenxhi@gmail.com | [signature] |
| 2 | Ilçe Kostofski | H2H Foundation | Kons. Mjedisi | 0686402909 | kostofski23@gmail.com | [signature] |
| 3 | ZAMIRA JAHO | H2H Foundation | kons. Mjedisi | 0693051377 | zamirajaho@hotmail.com | [signature] |
| 4 | Soimir Brahimi | FLAG PINE | Drejtues | 0692773191 | | [signature] |
| 5 | Pellumb Laho | Kisit Sazanit | Drejtues | 0692184873 | pillumblaho@hotmail.com | [signature] |
| 6 | Fatjon Nivle | CNVP Albania | | 0692053480 | [illegible]@cnvp.eu | [signature] |
| 7 | Aleksander Trajçe | PPNEA | Drejtor | 0682137184 | a.trajce@ppnea.org | [signature] |
| 8 | Ilona Pojani | FEUT | Profesore | 0684021203 | elonapojani@feut.edu.al | [signature] |
| 9 | Irma Temali | Bashkia Shkodër | Arkitekt | 0692180036 | irmatemi@yahoo.com | [signature] |
| 10 | Adar Rama | Gazeta | | 0692083304 | [illegible]@gmail | [signature] |
| 11 | Kristi Bashuri | AOS | GTP | 0696439829 | kristi.bashuri@aos.al.org | [signature] |
| 12 | Denise Balo | MENV Group | Kordinatore | 0696717005 | denisabalo@gmail.com | [signature] |
| 13 | Abolf Arifaj | Shop Bletarve Puka | | 682345742 | [illegible] | [signature] |
| 14 | | | | | | |
| 15 | | | | | | |

*Shënim: Duke firmosur këtë listë-prezencë, ju jeni dakord që fotografitë dhe regjistrimi i këtij Forumi të përdoren për publikim dhe raportim në kuadër të Green-AL*

Co-PLAN INSTITUTE FOR HABITAT DEVELOPMENT | VIS | CISP COMITATO INTERNAZIONALE PER LO SVILUPPO DEI POPOLI | COSV COORDINAMENTO DELLE ORGANIZZAZIONI PER IL SERVIZIO VOLONTARIO | Sweden Sverige

Co-PLAN INSTITUTE FOR HABITAT DEVELOPMENT | CISP COMITATO INTERNAZIONALE PER LO SVILUPPO DEI POPOLI | VOLONTARIATO INTERNAZIONALE PER LO SVILUPPO VIS ALBANIA | COSV COORDINAMENTO DELLE ORGANIZZAZIONI PER IL SERVIZIO VOLONTARIO | Sweden Sverige


Z.Eduard Shalsi


COSV
sweden 2023 eU

**Aneks 2 – Agjenda**

# FORUM KOMBËTAR

# "RUAJMË NATYRËN PËR NJË BASHKËJETESË TË QËNDRUESHME"

**Hotel Xheko-Imperial, Tiranë**

**26.05.2023**

Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore përkufizohet nga Konventa për Diversitetin Biologjik si "*përdorimi i përbërësve të diversitetit biologjik në një mënyrë dhe në një shkallë që nuk çon në rënien afatgjatë të diversitetit biologjik, duke ruajtur kështu potencialin e tij për të përmbushur nevojat dhe aspiratat. të brezave të sotëm dhe të ardhshëm.*"

Zonat e mbrojtura janë mekanizmi i kryesor për ruajtjen e biodiversitetit. Megjithatë, neni 8 (c) i Konventës së Biodiversitetit parashikon që palët duhet të promovojnë një zhvillim të qëndrueshëm mjedisor edhe në zonat ngjitur me zonat e mbrojtura me qëllim mbrojtjen e mëtejshme të këtyre vlerave.

Korniza Globale e Biodiversitetit pas 2020 kërkon mbrojtjen e të paktën 30% të sipërfaqes tokësore dhe detare deri në vitin 2030, Por ajo thekson se është po aq e rëndësishme që këto përpjekje të plotësohen dhe të mbështeten nga një menaxhim më i qëndrueshëm i pjesës së mbetur (70% e peizazheve tokësore dhe detare në një qasje mbarë globale.

Ruajtja e Natyrës kërkon një bashkërendim të veprimeve të të gjithë aktorëve që lidhen me ruajtjen dhe mirë menaxhimin e burimeve natyrore, që të sigurohet një bashkëjetesë e natyrës dhe e njerëzve në vazhdimësi dhe me një të ardhme të qëndrueshme.

Për të diskutuar mbi problematikat e ruajtjes së natyrës jo vetëm brenda zonave të mbrojtura dhe për të kuptuar më mirë rolin që organizatat/aktorët kyç të ndryshëm duhet të luajnë për të garantuar një përdorim të qëndrueshëm të burimeve natyrore që kontribuon në ruajtjen e vlerave të natyrës dhe biodiversitetit, Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri, në kuadër të programit Green-AL, financuar nga Qeveria Suedeze dhe zbatuar nga Co-Plan dhe partnerët, organizon **Forumin Kombëtar "Ruajmë natyrën për një bashkëjetesë të qëndrueshme"**, i cili do të zhvillohet në **mjediset e Hotel Xheko Imperial, Tiranë**, në datë **26 Maj 2023.**

Forumi synon të mbledhë bashkë një larmi aktorësh të angazhuar në ruajtjen e vlerave natyrore dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Shqipëri ku përfshihen organizatat jo fitim prurëse, grupet e përdoruesve të burimeve natyrore, përfaqësues të institucioneve qendrore e vendore përgjegjëse për menaxhimin e burimeve natyrore, donatorë aktivë në mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm, etj.

Bashkëngjitur ftesës, gjeni programin e forumit.

Lutemi konfirmoni pjesëmarrjen tuaj në këtë takim, brenda datës 20.05.2023 në info@inca-al.org.

Duke shpresuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj,

Me respekt,

**INCA**

# DRAFT PROGRAMI

Hotel Xheko Imperial, Tiranë, datë 26.05.2023

| | | |
|---|---|---|
| **Mirëseardhja** | | |
| **09:00 – 09:30** | Regjistrimi i pjesëmarrësve | |
| **Sesioni i parë – Ruajtja e natyrës në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm** | | |
